



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr. 9, datë 24.4.2020

**“MBI PËRFUNDIMET E ARRITURA PAS KËSHILLIMIT PUBLIK PËR
DOKUMENTIN “ANALIZË E TREGUT ME SHUMICË TË AKSES ORIGJINIMIT
NË RRJETET CELULARE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 24.4.2020, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 115, të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***“Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare”.***

BAZA LIGJORE:

1. Neni 31 e vijues i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (***Ligji nr.9918/2008***);
2. Ligj nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (***Ligji nr. 44/2015***);
3. Pika 5, e nenit 3, të Rregullores nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e Tregut”, e ndryshuar (***Rregullorja nr.9/2009***).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialeve si më poshtë:

- a) Dokumenti: “Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare”.
- b) Projekt Akti i formatuar: “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare”.
- c) Relacioni shpjegues i projekt aktit;

si dhe referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, duke arsyetuar në mbështetje të bazës ligjore referuese,

V Ë R E N:

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në cilësinë e organit të vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit nr.9918/2008, duke synuar promovimin e konkurrencës efektive/efiçente me qëllim sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike.
2. Me vendimin 747, datë 17.7.2009, (i ndryshuar) Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar Rregulloren nr. 9, “Mbi analizat e tregut” ku përcaktohet lista e tregjeve të cilat analizohen për të përcaktuar sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg dhe masat rregullatore. Tregu me shumicë i akses-origjinimit nuk është pjesë e kësaj liste.
3. Përjashtimisht nga kjo listë, përkufizimi i tregjeve që justifikojnë rregullimin apo mund të jenë subjekt i rregullimit paraprak (*ex ante*), në kuptimin e nenit 31 të ligjit, përfshin tregjet me pengesa, me natyrë juridike ose strukturore të larta dhe të qëndrueshme për hyrjen në treg, tregjet të cilat nuk janë të orientuar drejt konkurrencës efektive brenda një periudhe kohore të përshtatshme, tregjet ku zbatimi vetëm i ligjit për konkurrencën nuk mund të zgjidhë në mënyrën e duhur dështimet e tregut. AKEP ka tagër të kryejë analiza, për sa kohë mund të ketë indikacione apo mëdyshje lidhur me plotësimin kumulativ të këtyre tre kritereve në një nga tregjet në derregullim.
4. Sa më sipër dhe referuar procedurës së parashikuar nga nenet 31 e vijues të ligjit nr. 9918/2008, si dhe te Rregullores nr. 9/2009, Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 11, datë 17.04.2019, miratoi dokumentin “Analizë e tregut të shërbimeve celulare, tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare-dokument për këshillim publik”. Procedura e këshillimit publik u zhvillua gjatë periudhës 18.04.2019-20.06.2019.
5. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, në AKEP dorëzuan komente palët e interesuara: sipërmarrësit Telekom Albania sh.a. (11.06.2019; 26.02.2020), Albtelecom sh.a. (17.06.2019; 22.01.2020), Vodafone Albania sh.a. (18.06.2019; 25.02.2020), Neofone sh.p.k. (20.06.2019), Alban Tirana Nascendo Al. Sh.p.k. (15.06.2019).
6. Autoriteti i Konkurrencës, në cilësinë e garantit të zbatimit të legjisllacionit material dhe

parimeve të të drejtës së konkurrencës i adresoi AKEP, në kuadrin e analizës, një rekomandim paraprak, nëpërmjet vendimit nr. 635, datë 04.07.2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare” si dhe një rekomandim përfundimtar nëpërmjet vendimit nr. 661, datë 21.11.2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”.

7. AKEP shqyrtoi komentet e operatorëve dhe zhvilloi konsulta me organizma rregullatorë ndërkombëtarë. Rëndësi e veçantë iu kushtua gjithashtu, gjatë këtyre konsultave, krahasimit të veçorive të tregut të analizuar në vendet e BE dhe të rajonit.
8. AKEP analizoi së fundmi me vëmendje të posaçme vendimet e Autoritetit të Konkurrencës në dritën e objektivave të ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si edhe të rekomandimeve dhe praktikave më të mira të Trupit të Rregullatorëve të Bashkimit Europian (BEREC). E përbashkëta e këtyre instrumenteve normativë rezultoi nënrenditja e procesit të analizës së një tregu subjekt rregullimi, domosdoshmërisë për të identifikuar në të, të tre kriteret kumulativë të sipërpërmendur:
 - (i) Verifikimi i prezencës së barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes;
 - (ii) Verifikimi nëse një strukturë tregu nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin e një konkurrencë efektive brenda një afati kohor përkatës;
 - (iii) Vlerësimi nëse aplikimi vetëm i ligjit në fuqi që rregullon fushën e konkurrencës është ose jo i mjaftueshëm për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marre në shqyrtim.
9. Në kushtet kur tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare nuk është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuara në Rekomandimin e Komisionit Evropian të vitit 2003, si dhe të tregjeve të identifikuar në Rregulloren nr. 9/2009 të AKEP, dokumenti “Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare”, në të cilin ishte përfshirë për efekt të analizës dhe jo si pjesë e mëvetësishme edhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare, lipsej t’i nënshtrohej sërish verifikimit të saktësisë dhe efektivitetit të testit të tre kriterëve.
10. Referuar orientimeve dhe konkluzioneve të rekomandimit përfundimtar të Autoritetit të Konkurrencës, plotësimi i tre kriterëve për tregun e shumicës së akses-origjinimit nuk konsiderohet i karakterizuar nga pikëpamja e kuadrit normativ për mbrojtjen e konkurrencës. Për rrjedhojë, AKEP konstaton se ky kuadër është mjaftueshëm i pajisur për të ofruar të gjithë instrumentat dhe garancitë e duhura për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dhe në vijim problematikat e konkurrencës në tregun përkatës.

11. Vendimet e fundit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 679, datë 14.02.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare” dhe nr. 680, Datë 14.02.2020, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, dëshmojnë se në kushtet aktuale, ligji material për mbrojtjen e konkurrencës është i mjaftueshëm për të adresuar për zgjidhje problemet e konkurrencës në një treg të parregulluar *ex ante* dhe pjesërisht objekt i analizës në shqyrtim, atë me pakicë të shërbimeve celulare.
12. Për rrjedhojë, rregullimi *ex ante* i tregut me shumicë të akses-origjinimit, ndërhyrja paraprake e AKEP për përcaktimin e sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e detyrimeve rregullatore përkatëse, në referim të nenit 3, pika 5, të rregullores nr. 9/2009, nuk paraqiten si masa në përpjestim të drejtë me objektivin e mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efçente në kuadrin e ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për sa kohë ky objektivi është i realizueshëm nëpërmjet instrumenteve të legjislacionit specifik nën mbikqyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikës 5, të nenit 3 të Rregullores nr. 9/2009 “Për analizën e tregjeve”, e ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

VENDOSI

1. Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kritereve të sanksionuar në pikën 4 të nenit 3 të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut kryer sipas përcaktimeve dhe hapave proceduriale të parashikuara nga ligji 9918/2008 dhe Rregullorja 9/2009;
2. Të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimit të testit të tre kritereve, konform pikës 4 të nenit 5 të Rregullores;
3. Ky vendim publikohet në faqen e internetit www.akep.al;
4. Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Edlira Dvorani

Ketrin Topçiu

Xhoana Lilaj